



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:265585

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844905

C.nr.1265/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëseve L.B nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, F.Th nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit dhe A.K nga fshati Radoste, Komuna e Rahovecit, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson avokati S.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 1,790.00 euro, jashtë seancës, më datën 21.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses L.B.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses L.B, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 324 ditë pune të ja paguajë shumën prej 648.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 30.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbartimit të detyrueshëm.
- III. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëseve F.Th dhe A.K.
- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses F.Th, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 270 ditë pune të ja paguajë shumën prej 540.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 30.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri

në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm

- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.K, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 179 ditë pune të ja paguajë shumën prej 358.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 30.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm
- VI. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses F.Th për pjesën tjetër të padisë lidhur me kompensimin e ushqimit në punë mbi shumën prej 540 euro e deri në shumën prej 662 euro dhe atë për shumën prej 122 euro, për 61 ditëve të pranisë në punë.
- VII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses A.K për pjesën tjetër të padisë lidhur me kompensimin e ushqimit në punë mbi shumën prej 358 euro e deri në shumën prej 480 euro dhe atë për shumën prej 122 euro, për 61 ditëve të pranisë në punë.
- VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve L.B, F.Th dhe A.K, t'i paguajë shumën prej 229.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja L.B, F.Th dhe A.K, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 30.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 1,790.00 euro.

Të njëjtat sipas padisë kanë theksuar se kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë si mësimdhënëse në SHML “12 MAJI” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditëseve i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 22.02.2021, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 22.01.2021 e deri më 21.11.2022 dhe atë për paditësen L.B për 324 ditëve të pranisë në punë, për paditësen F.Th për 331 ditë të prezencës në punë dhe për paditësen A.K për 240 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 16.05.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse rezulton e pavlefshme. Më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrihen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditëses i kanë shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditëses nuk kanë parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. E njëjta ka theksuar se paditësja L.B, është e përfishirë me një padi tjetër për kompensim të ushqimit, për periudhën kohore 22.01.2021-21.11.2022, të evidentuar pranë kësaj gjykate C.nr. 164/2024, me numër të lëndës 2024:033972. Po ashtu paditësja F.Th, me Aktgjykim të plotëfuqishëm C.nr.190/2021, me numër të lëndës-2021:523525, të datës 16.05.2023, është kompensuar në emër të ushqimit në punë, për periudhën kohore 05.12.2019-18.04.2021. Si dhe paditësja A.K, me Aktgjykim të plotëfuqishëm C.nr.191/2021, me numër të lëndës 2021:053536, të datës 21.06.2022, është kompensuar në emër të ushqimit në punë, për periudhën kohore 05.12.2019-18.04.2021.Po ashtu i ka kontestuar në tërësi vërtetimet për ditët e punës të drejtorit të shkollës.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: për paditësen L.B, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 08/3804 i datës 30.11.2022, i lëshuar nga SHML “12 MAJI” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 06/2983, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses L.B.

Për paditësen F.Th: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 08/3806 i datës 30.11.2022, i lëshuar nga SHML “12 MAJI” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 06/2978, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses F.Th.

Për paditësen: A.K, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 08/3805 i datës 30.11.2022, i lëshuar nga SHML “12 MAJI” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënëse, e datës 01.03.2018, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses A.K.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditëset kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditëset për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditëseve pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 08/3804 i datës 30.11.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja L.B në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 324 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 06/2983, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditëses L.B dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHML “12 MAJI” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 08/3806 i datës 30.11.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja F.Th në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 331 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 06/2978, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditëses F.Th dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHML “12 MAJI” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 08/3805 i datës 30.11.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.K në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 240 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës, e datës 01.03.2018, të lidhur ndërmjet paditëses A.K dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHML “12 MAJI” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëseve, për faktin se paditëset në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin e tyre të punës kanë prezantuar paditësja L.B për 324 ditë të punës dhe F.Th për 331 ditë të punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditëset kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti e ka kontestuar e paditura. Në rast se shumëzohen 324 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 648.00 euro për paditësen L.B, ndërsa për

paditësen F.Th në rast se shumëzohen 331 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 662.00 euro.

Sa i përket pretendimeve të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja L.B është e përfishrë në padinë tjetër për kompensim të ushqimit, për periudhën kohore 22.01.2021-21.11.2022, e evidentuar me numër C.nr.164/2024 me numër të lëndës 2024:033972, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që gjykata ka verifikuar faktin që paditësja L.B është e përfshirë në padinë tjetër për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe jo për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit siç ka pretenduar e paditura.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht kërkespadinë të paditëses F.Th, për faktin se paditësja në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e saj të punës ka prezantuar në 331 ditët e punës, mirëpo gjykata e refuzoi për 61 ditë të punës x 2= 122 euro, për faktin se paditësja F.Th me aktgjykim të plotëfuqishëm të kësaj gjykate C.nr.190/2021 me numër të lëndës 2021:053525, të datës 17.05.2023, është kompensuar në emër të ushqimit në punë, për periudhën 05.12.2019 deri 18.04.2021, prandaj gjykata vendosi si në piken IV. dhe VI. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht kërkespadinë të paditëses A.K, për faktin se paditësja në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e saj të punës ka prezantuar në 240 ditët e punës, mirëpo gjykata e refuzoi për 61 ditë të punës x 2= 122 euro, për faktin se paditësja A.K me aktgjykim të plotëfuqishëm të kësaj gjykate C.nr.191/2021 me numër të lëndës 2021:053536, të datës 03.07.2022, është kompensuar në emër të ushqimit në punë, për periudhën 05.12.2019 deri 18.04.2021, prandaj gjykata vendosi si në piken V. dhe VII. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Baza juridike e kërkesëpadi së buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadi së paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del*

themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë të paditëses shumën si në pikën VIII të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 229 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 208 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1265/23, më datën 21.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.